

UDHËZIM
Nr. 1, datë 23.9.2016

**PËR MIRATIMIN/PËRCAKTIMIN E STRUKTURËS, KRITERET E PËRZGJEDHJES
DHE TRAJNIMIN E PUNONJËSVE TË NJËSISË PËRGJEGJËSE NË SUBJEKTET
PRIVATE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI),

UDHËZON:

Përcaktimin e rregullave për miratimin e strukturës, kritereve të përzgjedhjes dhe të trajnimit të punonjësve të njësisë përgjegjëse, e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet, në subjektet private, si më poshtë vijon:

1. Subjektet private sipas përkufizimit të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, të cilët kanë më shumë se 100 punonjës ngarkohen të krijojnë njësinë përgjegjëse, e cila ndjek në vazhdimësi procesin e sinjalizimit të një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni, si dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga hakmarrja në vendin e punës.

2. Subjektet private duhet të caktojnë njësinë përgjegjëse, si organ i posaçëm, i përbërë nga një ose më shumë persona, të trajnuar posaçërisht në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve, e cila regjistron, heton dhe shqyrton administrativisht sinjalizimet, si dhe shqyrton kërkesat për mbrojtjen e sinjalizuesit nga hakmarrja, sipas përcaktimeve të ligjit.

3. Njësia përgjegjëse ka për detyrë:

- a) të kryejë detyrat e përcaktuara në nenin 13 e vijues të ligjit;
- b) të veprorë me ndershmëri, integritet, paanshmëri, efikasitet dhe jashtë çdo influence të padrejtë që mund të pengojë realizmin e detyrave të saj në zbatim të ligjit nr. 60/2016;
- c) të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme gjatë procedurës së shqyrtimit në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit;
- ç) të regjistrojë sinjalizimet, të kryejë procedurën e hetimit administrativ, të marrë vendim për përfundimin e hetimit administrativ apo mosfillimin e tij dhe ta dokumentojë atë;
- d) të marrë të gjitha masat për shqyrtimin e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje të sinjalizuesit;
- dh) të raportojë mbi përfundimin e hetimit dhe problematikat e evidentuara gjatë procesit të shqyrtimit të hetimit administrativ pranë organeve mbikëqyrëse/drejtuese të subjektit privat.

4. Funksionet e njësisë përgjegjëse duhet të bëhen pjesë e përshkrimit të pozicionit të punës, si dhe të përcaktohen në rregulloren e brendshme të subjektit privat apo çdo akt tjetër të brendshëm të tij. Subjektet private duhet të garantojnë vazhdimësi në ushtrimin e funksioneve të njësisë përgjegjëse.

5. Subjektet private njoftojnë menjëherë me shkrim ILDKPKI-në për ngritjen e njësisë përgjegjëse, si dhe punonjës/in/t e caktuar apo të zgjedhur të kryejnë rolin e punonjësit në njësinë përgjegjëse.

6. Me ngritjen e njësisë përgjegjëse në zbatim të këtij udhëzimi, subjektet private ngarkohen të hartojnë dhe të miratojnë rregulloret e tyre të brendshme të posaçme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit, si dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit, bazuar në pikën 10, neni 3, si dhe për procedurën e shqyrtimit të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja, bazuar në pikën 8, neni 19, të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

7. Përpara caktimit apo përzgjedhjes për të qenë pjesë e njësisë përgjegjëse, punonjësi duhet të

plotësojë me shkrim deklaratën e pëlqimit ku pranon detyrën e punonjësit të njësisë përgjegjëse, në rast caktimi apo përzgjedhjeje nga subjekti privat.

8. Punonjësi i njësisë përgjegjëse duhet të përmbushë këto kritere:

a) të ketë mbaruar arsimin e lartë, i prefe-rueshëm në shkencat juridike, shkencat sociale ose shkencat ekonomike, diplomë e nivelit të dytë;

b) të ketë vjetërsi në profesion/punë jo më pak se tre vjet;

c) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë të rëndë penale;

ç) të ketë njohuri mbi ligjin e sinjalizimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave;

d) të gëzojë integritet të lartë profesional;

dh) të ketë aftësi profesionale për të vlerësuar administrativisht praktikën e sinjalizuar;

e) të ketë aftësi organizative, si dhe të angazhohet seriozisht në marrjen e masave për ndjekjen administrative të fakteve të sinjalizuara;

ë) të mos ketë marrë masa disiplinore në tri vitet e fundit;

9. Në rastet e lëvizjes, largimit nga funksioni/ detyra e njësisë përgjegjëse apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ndërmjet subjektit privat dhe punonjësit në cilësinë e anëtarit të njësisë përgjegjëse, njoftohet menjëherë Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së. Subjekti privat merr masat e nevojshme që të zëvendësojë menjëherë punonjësin e larguar të njësisë përgjegjëse, duke zbatuar kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.

10. Punonjësi i njësisë përgjegjëse mund të largohet nga detyra e anëtarit të njësisë përgjegjëse, në rastet kur:

a) jep dorëheqjen me shkrim;

b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) me vendim gjyqësor të formës së prerë deklarohet i paaftë për të vepruar;

ç) kryen shkelje të rëndë të legjislacionit që rregullon sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve;

d) përfundon marrëdhënia e punës sipas parashikimeve të Kodit të Punës;

dh) nuk paraqitet në punë për shkaqe të justifikuara për më shumë se 3 muaj.

11. Punonjësit e njësisë përgjegjëse në subjektet private i nënshtrohen trajnimit të detyrueshëm për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në ligjin nr. 60/2016 dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

12. Trajnimi organizohet në mënyrë periodike nga ILDKPKI-ja në bashkëpunim me subjektet private. Subjektet private janë të detyruara të mundësojnë pjesëmarrjen në trajnim nga punonjësit e njësive përgjegjëse, sa herë njoftohen paraprakisht nga ILDKPKI-ja.

13. Koha e periudhës së trajnimit, metodologjia e kryerjes së tij dhe lista e ekspertëve trajnues miratohet me urdhër të veçantë të Inspektorit të Përgjithshëm.

14. ILDKPKI-ja krijon dhe mban të përditësuar Regjistrin Kombëtar të Njësive Përgjegjëse në subjektet private në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

15. Ngarkohen subjektet private, sipas përcaktimit të bërë në nenin 3 të ligjit nr. 60/2016 dhe këtij udhëzimi, për zbatimin e këtij udhëzimi.

16. Veprimtaria e njësive përgjegjëse në subjektet private, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, fillon në datën 1 korrik 2017.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Ganaj